



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

ETIKOS

Etika e raportimit në media online (janar – dhjetor 2022)





Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA

Autor dhe botues: Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMShK)

www.presscouncil-ks.org

Ky raport është mbështetur nga Ambasada e Zvicrës në Kosovë. Gjetjet dhe konkluzionet e paraqitura këtu janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të donatorit.

Shkurt, 2023

PËRMBAJTJA

HYRJE	2
METODOLOGJIA	3
PRETENDIMET E SHKELJEVE ETIKE NË MEDIAT ONLINE	4
ANKESAT E MIRATUARA DHE TË REFUZUARA	6
PËRFUNDIME	10
ANEKS 1 – KODI I MEDIAVE TË SHKRUARA TË KOSOVËS	11
ANEKS 2 – ANKESAT E PRANUARA DHE TË TRAJTUARA GJATË VITIT 2022	14

Hyrje

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës është një trup vetërregullues i formuar për dhe nga sektori i mediave të shkruara. Misioni i tij mbështetet mbi bindjet e Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës. KMSHK është themeluar me ndihmën e OSBE-së në Kosovë në shtator të vitit 2005, ndërsa Zyra e KMSHK-së aktivitetin e rregullt e ka filluar në dhjetor të vitit 2005.

Fjala e lirë, e drejta e qytetarëve për t'u informuar plotësisht, me kohë, dhe respektimi në tërësi i kodit etik të gazetarisë janë baza mbi të cilën vepron KMSHK. Qëllimi i KMSHK-së është ta mbrojë qytetarin nga shkrimet e pavërteta si dhe ta mbrojë gazetarin nga ankesat e pambështetura.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës ka mbi 50 anëtarë të rregullt, dhe numri i tyre është duke u rritur. Kuvendi i anëtarëve përbëhet nga përfaqësuesit e gazetave, portaleve të lajmeve, revistave periodike, agjencive të lajmeve, dhe të blogjeve.

Strategjia e KMSHK-së për periudhën 2019-2024 shtrihet në fuqizimin e respektimit të Kodit të mediave të shkruara në Kosovë; edukimin e brezave të rinj të gazetarëve dhe studentëve të gazetarisë lidhur me parimet e Kodit të mediave të shkruara me qëllim të sigurimit të së drejtës së qytetarëve për t'u informuar drejt dhe me kohë.

Shkeljet e Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës kanë vazhduar të paraqiten kundër mediave anëtare dhe joanëtare, ndërsa Këshilli ka vazhduar të shtyjë përpara misionin e vet të ruajtjes së profesionalizmit medial në Kosovë.

Gjatë vitit 2022, KMSHK-ja ka pranuar **gjithsej 107 ankesa**.

Në mbledhjet e mbajtura gjatë kësaj vitit 2022, Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës **ka miratuar plotësisht 20 ankesa, ka miratuar pjesërisht 20 ankesa, ka hedhur poshtë 31 ankesa, 9 prej tyre janë shpallur të patrajtueshme**, ndërsa **1 ankesë** është zgjidhur me **ndërmjetësim**.

Sikurse edhe viteve paraprake, ankesat kryesisht kanë pasur të bëjnë me kapitullin që trajton raportimin e së vërtetës dhe lajmet e rreme, ndërsa ka pasur edhe ankesa lidhur me të drejtën për t'u përgjigjur si dhe privatësinë dhe mbrojtjen e burimeve.

Metodologjia

Ky raport është realizuar duke u mbështetur në të dhënat që Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës i ka marrë dhe i ka procesuar gjatë vitit 2022.

Duke marrë parasysh se ankesat që i pranon Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës zakonisht përmbajnë më shumë se një pretendim të shkeljeve të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës, raporti është përpiluar asisoi duke kategorizuar:

- Pretendimet e shkeljeve të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës – ku janë përfshirë të gjitha pretendimet që KMSHK-ja i ka pranuar gjatë vitit 2022 lidhur me shkeljet e Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës, dhe

- Vendimet e marra nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës lidhur me pretendimet në fjalë. Këtu hyjnë shkeljet e miratuara dhe ato të refuzuara.

Arsyeja për një metodologji të këtillë është që mediave tona anëtare dhe opinionit të gjerë t'ua ofrojmë një pasqyrë të asaj që ata hasin në media online çdo ditë, pra të atij raportimi që opinion publik rëndom e konsideron si joprofesional, si shkelje të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

Pra, fokusi në pretendimet e shkeljeve është që të ofrohet një pasqyrë mbi perceptimin e opinionit rreth cilësisë dhe profesionalizmit të raportimit medial në Kosovë.

Pretendimet e shkeljeve etike në mediat online

Në këtë kapitull janë paraqitur të gjitha shkeljet e pretenduara të cilat Këshilli i Mediave të Shkruara i ka pranuar gjatë vitit 2022.

Siç është cekur edhe në metodologjinë më lart, kjo pjesë shtjellon shkeljet e pretenduara, pra ankesat që KMSHK-ja i ka pranuar nga opinion publik dhe nga mediat e tjera lidhur me raportimin profesional, raportimin joetik, me kapituajt dhe paragrafët dhe pikat e Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

Gjatë vitit 2022, Këshilli i Mediave të Shkruara i ka procesuar 167 pretendime të shkeljeve të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

Më poshtë, gjeni pretendimet për shkelje sipas muajve.




Figura 1. Pretendimet e shkeljeve sipas muajve, 2022

Figura tregon se trendi i dërgimit të ankesave në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës është konstant. Përjashtim këtu bën muaji prill, ku kemi pasur më se 54 pretendime të shkeljeve të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës, derisa në muajin dhjetor nuk kemi pranuar ankesa.

Në vijim janë të paraqitura pretendimet e shkeljeve sipas muajve dhe sipas kapitujve të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR
I				3								
II	6	4	5	24	10	8	12	6	1	7	1	
III			4			2		1			1	
IV	2	2		20	9	8	6	2		4		
V	2		3	4		1						
VI												
VII	1			1	1				1	1		
VIII												
IX	1											
X												
XI				2		1						
XII												
	12	6	12	54	20	20	18	9	2	12	2	0

Figura 2. Pretendimet e shkeljeve sipas kapitujve

Në Këshillin e Mediave të Shkruara vazhdojnë të vijnë anksat në lidhje me shkeljet e Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës, ndërsa problem më të madh në raportim – gjithmonë sipas lexuesve dhe atyre që preken drejtpërdrejt nga raportimi – vazhdon të jetë raportimi i së vërtetës i cili është i rregulluar brenda Kapitullit II të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës, apo Raportimi i së vërtetës.

Pika 1 e këtij kapitulli thotë:

“Gjatë punës së tyre, gazetarët dhe redaktorët do të sigurojnë respekt për të vërtetën faktike dhe për të drejtën e publikut që ta dijë të vërtetën.”

Po ashtu, diçka që tradicionalisht ka qenë lëndë e ankesave pranë Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, është demanti apo e drejta për t’u përgjigjur, dhe Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës parasheh që: *“është obligim i gazetarëve, redaktorëve dhe i gazetave, portaleve e agjensive të lajmeve që të botojnë reagime dhe/ose demante kur mediat publikojnë informata të pasakta për një individ apo organizatë”*.

Kështu, *Raportimi i së vërtetës* dhe e *Drejta për t'u përgjigjur*, gjegjësisht Kapitulli II dhe Kapitulli IV i Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës vazhdojnë të jenë dy aspektet kryesore të cilat trajtohen nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, dhe të cilat vazhdojnë të përbëjnë sfidë në raportimin e mediave online në Kosovë.

Ankesat e miratuara dhe të refuzuara

Në këtë kapitull shtjellohen ankesat të cilat Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës – pra pretendimet e shkeljeve të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës të cilat KMSHK-ja i ka miratuar si të bazuara apo i ka hedhur poshtë si të pabazuara dhe të paafatshme (në disa raste).

Siç u cek edhe në metodologji, kjo pjesë shtjellon të gjitha pretendimet të cilat KMSHK-ja i ka pranuar gjatë vitit 2022 dhe të gjitha vendimet të cilat ky trup vetërregullues i mediave online i ka marrë lidhur me pretendimet në fjalë.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në vitin 2022 i ka mbajtur 8 mbledhje të kuvendit.

Gjatë vitit 2022, Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës ka pranuar dhe ka shqyrtuar **gjithsej 167 pretendime për shkelje të hartuara në 107 ankesa** (Ankesat dhe pretendimet e detajuara mund t'i gjeni në Aneksin 2).

Ankesat kryesisht kanë të bëjnë me shkeljet e pretenduara të:

- *Kreut II (Raportimi i së vërtetës),*
- *Kreut IV (E drejta për t'u përgjigjur),*
- *Kreut VII (Privatësia),*
- *Kreut V (Personat e përfshirë në incidente, aksidente, të arrestuar apo të akuzuar për vepra penale),*
- *Kreut III (nxitja dhe gjuha e urrejtjes), dhe*
- *Kreut XI (Të drejtat e autorit) të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës,*

Gjithashtu, ka pasur edhe shkelje të tjera të kapitujve Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

Sekretariati i KMSHK-së, në raste të nevojshme ndërmjetëson me mediat në mënyrë që të gjendet një marrëveshje, duke mos pasur nevojë që të dërgohet ankesë.

Në tabelën në vijim mund t'i shihni të gjitha vendimet e miratuara për vitin 2022.




Figura 3. Pretendimet e miratuara sipas muajve, 2022

Siç mund të shihet nga Figura 3, më së shumti vendime për shkelje janë marrë gjatë muajve maj, qershor dhe korrik, duke qenë se këtu edhe vëllimi i ankesave ka qenë më i madh. Në vijim janë paraqitur edhe shifrat e pretendimeve të cilat Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës i ka hedhur poshtë.




Figura 4. Pretendimet e refuzuara sipas muajve, 2022

Nëse i shikojmë këto sipas kapitujve, në vijim janë paraqitur grafikisht pretendimet e miratuara dhe të refuzuara nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës.

	SHKURT	MARS	MAJ	QERSHOR	KORRIK	SHTATOR	TETOR	DHJETOR
I								
II	3	3	3	6	2	3	6	2
III							3	1
IV	3	1	7	5	9	4		
V								
VI								
VII				1				
VIII								
IX								
X								
XI			1					
XII								
	6	4	11	12	11	7	9	3

Figura 5. Pretendimet e miratuara sipas kapitujve

Duke u nisur nga pretendimet e shkeljeve që Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës i ka pranuar gjatë vitit 2022, mund të shohim se edhe vendimet e marra (si për miratim ashtu edhe për refuzim) më së shumti kanë të bëjnë me shkeljen e Kapitullit II dhe Kapitullit IV, gjegjësisht me shkeljen e raportimit të së vërtetës dhe të së drejtës për t'u përgjigjur.

Në vijim janë paraqitur edhe pretendimet e hedhura poshtë, sipas muajve dhe sipas kapitujve të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

	SHKURT	MARS	MAJ	QERSHOR	KORRIK	SHTATOR	TETOR	DHJETOR
I			3					
II	7	1	15	5	10	14	2	2
III		4			1			1
IV	2		2		2	6	1	
V	4		4	3	1			
VI								
VII	1				1	1		1
VIII								
IX								
X								
XI		1	1		1			
XII								
	14	6	25	8	16	21	3	4

Figura 6. Pretendimet e refuzuara sipas kapitujve

Përfundime

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMShK), si trup vetërregullues i mediave të shkruara dhe online në Kosovë, synon që pjesë të veten të bëjë sa më shumë media. Në këtë mënyrë, ato obligohen të respektojnë Kodin e Etikës dhe, po ashtu, të kontribuojnë për një gazetari etike dhe të përgjegjshme.

Trendi i ankesave dhe pretendimeve të ngritura nga palët gjatë periudhës së raportimit është i gjashëm me periudhat paraprake.

Sipas të dhënave të përfshira në këtë raport, KMShK ka pranuar më së shumti ankesa me pretendimin se janë shkelur kapitujt që kanë të bëjnë me raportimin e së vërtetës dhe të drejtën për t'u përgjigjur, por vërehet edhe shtimi i numrit të ankesave që kanë të bëjnë me privatësinë dhe mbrojtjen e burimeve.

Gjatë kësaj periudhe më se gjysma e ankesave janë miratuar, ndërkaq një numër janë orientuar në Komisionin e Pavarur për Media (KPM), pasi që kanë pasur të bëjnë me shkeljet e pretenduara në televizione.

KMShK ka shqyrtuar edhe ankesa të mediave ndaj mediave të tjera, të cilat kanë pasur të bëjnë kryesisht me të drejtën e autorit.

KMShK do të vazhdojë t'i inkurajojë të gjithë konsumuesit e përmbajtjeve mediale në mediat e shkruara dhe online që, për të gjitha pretendimet për shkelje etike, t'i drejtohen këtij trupi vetërregullues.

Po ashtu, do të vazhdojë të punojë ngushtë me media, me akterë relevantë në fushën e gazetarisë dhe partnerë nga sektori joqeveritar, akademik dhe institucionet, për edukimin medial dhe respektimin e etikës gjatë raportimit.

Aneks 1 – Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës

Preambula

- Ky Kod, i derivuar nga standardet ekzistuese ndërkombëtare të praktikës së gazetarisë, mëton të shërbejë si bazë për sistemin vetërregullues i cili do të konsiderohej profesionalisht dhe moralisht i obligueshëm për gazetarë, reporterë, redaktorë, pronarë dhe botues të gazetave, portaleve dhe agjensive të lajmeve.
- Gazetarët dhe redaktorët do të respektojnë parimet etike në vijim dhe do të mbrojnë integritetin profesional të gazetarisë.
- Redaktorët dhe botuesit do të sigurojnë që i mbarë stafi relevant punues është i informuar për këtë Kod. Tutje, ata do të sigurojnë respektimin e të gjitha dispozitave të këtij Kodi.

I. Dispozitat e përgjithshme

1. Është detyrë e gazetarëve dhe e botuesve të respektojnë të drejtën e qytetarëve për informim me kohë dhe në plotëni. Gazetarët dhe botuesit do të mbrojnë parimet e lirisë së informimit, të drejtën në komentim të drejtë dhe në gazetari kritike.
2. Shtypi dhe portalet në Kosovë do të respektojnë standardet ndërkombëtare të mirësjelljes dhe të llojllojshmërisë etnike, kulturore dhe fetare.
3. Gazetarët dhe redaktorët nuk do të inkurajojnë, qëllimisht apo tërthorazi, diskriminimin dhe jotolerancën.
4. Gazetarët nuk do të veprojnë si përfaqësues të opinionit publik. Mediat nuk mund t'i zëvendësojnë funksionet specifike të autoriteteve apo institucioneve publike.
5. Vëzhgimi kritik i implementimit të pushtetit politik dhe ekonomik do të jetë ndër obligimet qenësore të shtypit dhe portaleve.
6. Organizatat mediale/të lajmeve do të dëshmojnë transparencë në çështjet e pronësisë dhe të menaxhimit të mediave, duke u mundësuar kështu qytetarëve qartësi rreth identitetit të pronarëve dhe të sasisë së interesit të tyre ekonomik në media.

II. Raportimi i së vërtetës

1. Gjatë punës së tyre, gazetarët dhe redaktorët do të sigurojnë respekt për të vërtetën faktike dhe për të drejtën e publikut që ta dijë të vërtetën.
2. Gazetarët dhe redaktorët, në parim, duhet të mbështeten në burime të identifikueshme të informacioneve.
3. Gazetat, portalet dhe agjensitë e lajmeve dhe publikimet e tyre janë të obliguara të mbrojnë identitetin e atyre të cilët ofrojnë informacione në konfidencë, pavarësisht nëse kjo është kërkuar paraprakisht apo jo.
4. Duhet të bëhet dallim i qartë ndërmjet lajmeve dhe opinionëve. Lajmi nënkupton informacion të përbërë nga faktet dhe të dhënat, kurse opinionet bartin mendime, ide, besime apo gjykime vlerësuese nga ana e botuesve, gazetarëve dhe redaktorëve.
5. Gazetarët dhe publikimet e tyre kanë obligim profesional që me kohë ta korrigjojnë çfarëdo informacioni të publikuar për të cilin vërtetohet të jetë i pasaktë.
6. Fotografitë dhe dokumentet nuk guxojnë të falsifikohen dhe/apo të përdoren në mënyrë të gabueshme.

7. Gazetari nuk guxon të bëjë plagjiat dhe duhet të theksojë burimin e informatës që është publikuar diku tjetër.

III. Nxitja dhe gjuha e urrejtjes

1. Shtypi, portalet dhe agjensitë e lajmeve nuk do të nxisin veprime kriminale apo të dhunshme, pavarësisht nga situata apo rrethana.
2. Shtypi, portalet dhe agjensitë e lajmeve do të bëjnë të gjitha që mundën për të mos nxitur apo ushqyer urrejtje dhe pabarazi përmes:
 1. Trajtimin me paragjykim të një individi apo grupi mbi baza të përkatësisë etnike, fetare, gjinore, racore, martesore, moshore apo të paaftësisë fizike e mendore;
 2. Përdorimit të shprehjeve denigruese me qëllim të lëndimit dhe kërcënimit të një individi apo grupi mbi baza të përkatësisë etnike, fetare, gjinore, racore, martesore, moshore apo të paaftësisë fizike e mendore.
3. Referencat rreth përkatësisë etnike të një individi, referencat racore, fetare, gjinore, të orientimit seksual apo rreth paaftësisë fizike e mendore do të zhvillohen vetëm në rastet kur informacionet e tilla kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ngjarjen për të cilën raportohet.

IV. E drejta për t'u përgjigjur

1. Është obligim i gazetarëve, redaktorëve dhe i gazetave, portaleve e agjensive të lajmeve që të botojnë reagime dhe/ose demante kur mediat publikojnë informata të pasakta për një individ apo organizatë.
2. E drejta për t'u përgjigjur do t'u mundësohet personave përkatës nëse botimi në fjalë përcakton që duhet të ndërmerret një hap të tillë për qëllime të korrektësisë dhe paanshmërisë. Duhet të ekzistojë mundësi për publikim të menjëhershëm të reagimit/përgjigjes në median e njëjtë.
3. Gjatë raportimit dhe komentimit të një ngjarjeje kontraverse, gazetatat, portalet dhe agjensitë e lajmeve do të përpiqen t'i dëgjojnë dhe t'i përfaqësojnë të gjitha palët në kontest. Nëse njëra palë brenda kontraversës refuzon të jetë në dispozicion për gazetarin, publikimi do të duhej ta theksojë këtë refuzim gjatë raportimit të vet.

V. Personat e akuzuar për vepra penale

1. Gazetat, portalet dhe agjensitë e lajmeve nuk do ta trajtojnë asnjë individ si fajtor, para se një vendim i tillë të konfirmohet nga gjykata.
2. Gazetarët dhe redaktorët janë të obliguar të mos prejudikojnë fajësinë e një personi të akuzuar.

VI. Mbrojtja e fëmijëve dhe të miturve

1. Gazetarët nuk do të duhej të intervistojnë apo të fotografojnë fëmijë nën moshën 18 vjeçare rreth çështjeve të cilat bëjnë fjalë për familjen e tyre, pa pëlqimin e prindit apo të ndonjë të rrituri i cili është përgjegjës për fëmijën.
2. Gazetat, portalet dhe agjensitë e lajmeve në asnjë mënyrë nuk do të identifikojnë fëmijët nën moshën 18 vjeçare të cilët janë të përzier në vepra penale, qoftë si dëshmitarë, apo të pandehur.
3. Trajtimi i rrëfimeve mbi tragjeditë personale duhet të zhvillohet me kujdes, ndërkohë që ndaj individëve të prekur me tragjedi duhet pasur qasje mirëkuptimi dhe diskrecioni.

VII. Privatësia

1. Gazetat, portalet dhe agjensitë e lajmeve do t'u shmangen ndërhyrjeve dhe kërkimeve në jetën private të një individi, përderisa ndërhyrje apo kërkime të tilla janë të nevojshme për arsye të interesit publik.

VIII. Korrupsioni dhe mitoja

1. Gazetarët nuk do të pranojnë poste, mito apo cytje të tjera të cilat shkaktojnë konflikte interesi me profesionin e tyre, dhe të cilat komprometojnë kredibilitetin e tyre moral dhe profesional.

IX. Të drejtat e autorëve

1. Botuesit, redaktorët dhe gazetarët në asnjë situatë nuk do të insistojnë në pronësi mbi lajmin.
2. Publikimet do të mund të përdoren arsyeshëm, dhe me citate të kufizuara, material nga publikime të tjera apo nga pronarë të së drejtës autoriale, pa leje të shprehur të tyre për ta bërë këtë. Megjithatë, botimi i materialit komplet do të duhej të ishte i mundur vetëm pas lejimit paraprak, të dhënë nga mbajtësi i të drejtës autoriale.

X. Reklamat dhe Sponsorimi

1. Reklamimi komercial e politik, si dhe materiali sponsorues përfshirë këtu edhe artikuj apo shtojca, duhet të jetë qartë i dallueshëm nga përmbajtja editoriale dhe të identifikohet qartë se çfarë është.
2. Materiali i sponsoruar do të tregojë qartë burimin e sponsorimit.

Aneks 2 – Ankesat e pranuar dhe të trajtuara gjatë vitit 2022

1. Ankesa nga Bedri Pllana kundër Jëpi Ze – e patrajtueshme
2. Ankesa nga Agim Lushta kundër Kosova Imë – nuk miratohet
3. Ankesa nga Lindita Gashi kundër Paparaci – miratohet
4. Ankesa nga Ilir Maliqi kundër Koha Ditore – nuk miratohet
5. Ankesa nga Alban Kamberi kundër Indeks online – e patrajtueshme
6. Ankesa nga Valdon Bytyqi kundër Gazeta Blic – nuk miratohet
7. Ankesa nga Halit Gashi përfaqësuar nga Av. Majlinda Kollçaku Libusha kundër Indeks online – e paafatshme
8. Ankesa nga Halit Gashi përfaqësuar nga Av. Majlinda Kollçaku Libusha kundër Infokus – e paafatshme
9. Ankesa nga Arsim Zuka kundër Gazeta Express, Periskopi dhe Paparaci – miratohet
10. Ankesa nga Sahide dhe Safete Mustafa të përfaqësuar nga Av. Flamur Bllacaku kundër Indeks online dhe Kosovarja – miratohet pjesërisht
11. Ankesa nga Albulena Haxhiu kundër Demokracia.com, Insajderi.org, Gazeta Blic, Sinjali dhe Periskopi – miratohet pjesërisht
12. Ankesa nga Posta e Kosovës Sh.a. kundër Demokracia.com – miratohet pjesërisht
13. Ankesa nga Tringë Sokoli kundër Ndertimi.info – e patrajtueshme
14. Ankesa nga Berat Luzha i përfaqësuar nga Avokat Xhevdet Smakiqi kundër Bota Sot Info – miratohet
15. Ankesa nga Federata e Futbollit të Kosovës kundër Gazeta Metro – miratohet
16. Ankesa nga Bashkësia Islame në Pejë kundër Insajderi.org – miratohet
17. Ankesa nga Ereza Dika kundër Mitrovica Sot – e patrajtueshme
18. Milica Andric kundër Ekonomia Online dhe Telegrafi – nuk miratohet
19. Ankesa nga Youth Initiative for Human Rights - YIHR kundër Ekonomia Online – nuk miratohet
20. Ankesa nga Youth Initiative for Human Rights - YIHR kundër Telegrafi.com – nuk miratohet
21. Ankesa nga Youth Initiative for Human Rights - YIHR kundër Arenamediale.tv – e patrajtueshme
22. Ankesa nga Nexhmedin Spahiu kundër Bota Sot – e patrajtueshme
23. Ankesa nga Genc Nimoni, në emër të Ministrisë së Drejtësisë kundër Nacionale – miratohet pjesërisht
24. Ankesa nga Genc Nimoni, në emër të Ministrisë së Drejtësisë kundër Front Online – nuk miratohet
25. Ankesa nga Demira Krujezi kundër Gazeta Papirus – miratohet
26. Ankesa Albulena Haxhiu kundër Paparaci – miratohet pjesërisht
27. Ankesa nga Milot Podvorica kundër Paparaci – miratohet pjesërisht
28. Ankesa nga Milot Podvorica kundër Insajderi – miratohet pjesërisht
29. Ankesa nga Arlind Manxhuka kundër Insajderi – nuk miratohet
30. Ankesa nga Remzi Selimi kundër Insajderi dhe Paparaci – miratohet
31. Ankesa nga Mefail Bajqinovci kundër Gazeta Metro – miratohet
32. Ankesa nga Arlind Manxhuka kundër Demokracia.com – nuk miratohet
33. Ankesa nga Arlind Manxhuka kundër Insajderi – nuk miratohet
34. Ankesa nga Ramadan Budakova kundër Insajderi – miratohet pjesërisht
35. Ankesa nga Florim Zuka kundër Insajderi (Insporti.com) – nuk miratohet
36. Ankesa nga Radio Televizioni i Kosovës kundër Demokracia.com, Insajderi.org, radiokosovaelire.com, tevel dhe Ballkani.info – miratohet
37. Ankesa nga Bezat Halilaj kundër Gazeta Infokus – nuk miratohet

38. Ankesa nga KESCO sh.a kundër KosovaPress – nuk miratohet
39. Ankesa nga Asdren Gjokolli dhe Elita Rudi Gjokolli përfaqësuar nga Kerveshi & Partners kundër Demokracia.org – nuk miratohet
40. Ankesa nga Asdren Gjokolli dhe Elita Rudi Gjokolli përfaqësuar nga Kerveshi & Partners kundër Insajderi – nuk miratohet
41. Ankesa nga Asdren Gjokolli dhe Elita Rudi Gjokolli përfaqësuar nga Kerveshi & Partners kundër BotaPress – nuk miratohet
42. Ankesa nga Albulena Haxhiu kundër Insajderi – miratohet pjesërisht
43. Ankesa nga Nacionale kundër Gazeta Express – nuk miratohet
44. Ankesa nga Mirlinda Imami Arikfidan të përfaqësuar nga Av. Saranda Keqekolla Sadiku kundër Insajderi – e paafatshme
45. Ankesa nga Mirlinda Imami Arikfidan të përfaqësuar nga Av. Saranda Keqekolla Sadiku kundër Bota Sot – e paafatshme
46. Ankesa nga Lorik Tigani dhe Rina Imami Tigani të përfaqësuar nga Av. Saranda Keqikolla Sadiku kundër Insajderi – e paafatshme
47. Ankesa nga Lorik Tigani dhe Rina Imami Tigani të përfaqësuar nga Av. Saranda Keqikolla Sadiku kundër Indeksonline – e paafatshme
48. Ankesa nga Lorik Tigani dhe Rina Imami Tigani të përfaqësuar nga Av. Saranda Keqikolla Sadiku kundër Paparaci – e paafatshme
49. Ankesa nga Lorik Tigani dhe Rina Imami Tigani të përfaqësuar nga Av. Saranda Keqikolla Sadiku kundër Bota Sot – e paafatshme
50. Ankesa nga Genc Nimoni në emër të Ministrisë së Drejtësisë kundër Paparaci – miratohet
51. Ankesa nga Asdren Gjokolli dhe Elita Rudi Gjokolli përfaqësuar nga Kerveshi & Partners kundër Insajderi – nuk miratohet
52. Ankesa nga Asdren Gjokolli dhe Elita Rudi Gjokolli përfaqësuar nga Kerveshi & Partners kundër Front Online – nuk miratohet
53. Ankesa nga Asdren Gjokolli dhe Elita Rudi Gjokolli përfaqësuar nga Kerveshi & Partners kundër Demokracia – nuk miratohet
54. Ankesa nga Rrezona Rexha dhe Ledian Rexha kundër Demokracia.com dhe Insajderi.org – miratohet pjesërisht
55. Ankesa nga Nexhmedin Sllamniku kundër Epilogu – miratohet
56. Ankesa nga Igballe Qena kundër Telegrafi – miratohet
57. Ankesa nga Liburn Aliu kundër Periskopi – miratohet pjesërisht
58. Ankesa nga Fatbardh Dabinovci kundër Gazeta Metro dhe Demokracia – miratohet
59. Ankesa nga Zyra e Avokatit të Popullit kundër Shqip.com – me ndërmjetësim
60. Ankesa nga Besnik Boletini, kryetar i Bordit të RTK kundër portalit të lajmeve New Born - miratohet
61. Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) kundër Demokracia.com – nuk miratohet
62. Ankesa nga Shkumbin Ahmetxhekaj, UD drejtor i përgjithshëm i RTK-së, dhe Arsim Halili, UD zëvendës drejtor i përgjithshëm i RTK-së kundër portalit të lajmeve New Born- miratohet
63. Ankesa nga Lab Oil Sh.P.K kundër gazetës online Insajderi – nuk miratohet
64. Ankesa nga Nagip Krasniqi kundër portalit Nacionale – miratohet pjesërisht
65. Ankesa nga Nagip Krasniqi kundër portalit Kosova.live – miratohet pjesërisht
66. Ankesa nga Nagip Krasniqi kundër portalit Syri.net – miratohet pjesërisht

67. Ankesa nga Arbërie Nagavci kundër portalit Demokracia – miratohet pjesërisht
68. Ankesa nga Arbërie Nagavci kundër portalit Demokracia – miratohet pjesërisht
69. Merlinda Aliu kundër Gazeta Demos dhe media në Facebook – e patrajtueshme
70. Ankesa nga Besnik Boletini, kryetar i Bordit të RTK kundër Gazeta New Born - miratohet
71. Ankesa nga Avni Shkodra kundër gazetës online Insajderi – miratohet pjesërisht
72. Ankesa nga Florent Ramqaj kundër portalit Nacionale - miratohet pjesërisht
73. Ankesa nga Driton Morina kundër portaleve Demokracia dhe Ballkan.info - miratohet pjesërisht
74. Ankesa nga Haki Abazi kundër portalit Albanian Post – nuk miratohet
75. Ankesa nga Alfa.I Sh.P.K. të përfaqësuar nga Pro Juris Law Firm kundër gazeta Nacionale - miratohet pjesërisht
76. Ankesa nga Pal Lekaj kundër portalit Front Online – e patrajtueshme
77. Ankesa nga Albanian Post kundër portalit Koha.net – e patrajtueshme
78. Ankesa nga Infratek të përfaqësuar nga Pro Juris Law Firm kundër gazeta Nacionale - miratohet pjesërisht
79. Ankesa nga Idriz Shala kundër gazeta Nacionale - miratohet pjesërisht
80. Ankesa nga Jeta Xharra kundër portalit Botapress – miratohet
81. Ankesa nga Jeta Xharra kundër portalit A-news24 – e patrajtueshme
82. Ankesa nga Jeta Xharra kundër gazeta Nacioanle – miratohet
83. Ankesa nga Lëvizja Vetëvendosje kundër portalit Gazeta Express – nuk miratohet
84. Ankesa nga Lëvizja Vetëvendosje kundër portalit Insajderi – nuk miratohet
85. Ankesa nga Lëvizja Vetëvendosje kundër portalit të lajmeve Gazeta Metro – nuk miratohet
86. Ankesa nga Lëvizja Vetëvendosje kundër portalit të lajmeve Gazeta Metro – nuk miratohet
87. Ankesa nga Kosmonte Foods kundër gazeta Nacionale – nuk miratohet
88. Ankesa nga Shkumbin Ahmetxhekaj, drejtor i përgjithshëm i RTK-së dhe Arsim Halili, zëvendës-drejtor i përgjithshëm i RTK-së, kundër Kallxo.com, GazetaBlic, GazetaExpress, Telegrafi, Insajderi, Paparaci, Reporteri, GazetaMetro, Infokus, Botapress, Republika Post dhe Mekuli Press – nuk miratohet
89. Ankesa nga Fadil Hoxha kundër Sinjali – nuk miratohet
90. Ankesa nga Migros Group Sh.P.K. kundër portalit Gazeta Blic – nuk miratohet
91. Ankesa nga Xhavit Haliti të përfaqësuar nga Avokat Faton Fetahu kundër portalit Bota Sot – nuk miratohet
92. Ankesa nga Elbert Krasniqi Partia IRDK kundër Insajderi – e patrajtueshme
93. Ankesa nga Gizzi Grill Sh.P.K. të përfaqësuar nga Avokate Teuta Zhinipotoku kundër portalit Sinjali – nuk miratohet
94. Ankesa nga Arjan Janova përfaqësuar nga Av.Jeton Idrizi dhe Aldo shpk kundër Nacionale – miratohet
95. Ankesa nga Ibrahim Krivaqa kundër Insajderi – nuk miratohet
96. Ankesa nga Lumjan Tolaj kundër revistës, versionit online Kosovarja – nuk miratohet
97. Ankesa nga OJQ Cohesion përfaqësuar nga Avokat Kastriot Feka kundër Insajderi – nuk miratohet
98. Ankesa nga Behxhet Pacolli të përfaqësuar nga Avokat Shkumbin Asllani kundër Kosova Sot Online – miratohet
99. Ankesa nga Festime Sijarina Luta kundër Bota Press – miratohet
100. Ankesa nga Luan Aliu të përfaqësuar nga avokate Albesjana Rexhepi Uka kundër Insajderi – miratohet
101. Ankesa nga Mrika Limani Myrtaj kundër Periskopi – miratohet pjesërisht

102. Ankesa nga Dimal Basha kundër Indeksonline – miratohet
103. Ankesa nga Dimal Basha kundër Gazeta Metro – miratohet
104. Ankesa nga IPKO kundër Bzz Mark – e ptrajtueshme
105. Ankesa nga Dimal Basha kundër Kanal 10 – e patrajtueshme
106. Ankesa nga Blerim Vela kundër Demokracia – miratohet
107. Ankesa nga Trepharm Sh.p.k. të përfaqësuar nga Avokate Erblina Krasniqi kundër Gazeta Shneta – nuk miratohet
108. Ankesa nga Sadri Daka kundër Sinjla – nuk miratohet
109. Ankesa nga Gentiana Begolli Pustina kundër Kosovalive.net – miratohet
110. Ankesa nga Drenusha Morina kundër Kosovo 2.0 – e paafatshme

